



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

---

Numri i lëndës: 2018:040273  
Datë: 16.09.2024  
Numri i dokumentit: 06163420

PML.nr.543/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit Q. M., për shkak të veprës penale “Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm”, nga neni 365, paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 374, paragrafi 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, PKR.nr.21/2020 të datës 03.05.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.345/2023 të datës 26.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit Q.M., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, PKR.nr.21/2020 të datës 03.05.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.345/2023 të datës 26.04.2024.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.21/20 të datës 03.05.2023, i dënuari Q. M. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm”, nga neni 365, paragrafi 1 të KPRK-së dhe veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni

374, paragrafi 1 të KPRK-së dhe ndaj të njëjtit është shqiptuar dënimi unik me gjobë në shumë prej 4,600.00 (katërmijegjashtëqind ) euro, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 24.07.2018 deri me datën 23.08.2018 dhe në arrest shtëpiak prej datës 24.08.2018 deri më datën 24.12.2018, ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak do të llogaritet nga njëzet (20) euro, ndërsa dënimin me gjobë është detyruar që ta paguaj në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Është detyruar i dënuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën mjeko-ligjore shumë prej njëzet (20) euro, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej pesëdhjetë (50) euro, si dhe shumë prej pesëdhjetë (50) euro në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.345/2023 e datës 26.04.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të dënuarit Q. M., avokati Nexhmedin Gashi, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe në rast të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovojë kërkesën, kurse t'i anulojë aktgjykimet e lartcekura dhe lëndën ta kthej në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim, ose të ndryshohet vendimi i dënimit të formës së prerë për të dënuarin Q. M.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.317/2024 e datës 03.09.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa është e pabazuar.

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, mbrojtësi në përgjithësi thekson se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës shkallës së dytë janë marrë me shkelje të dispozitave të procedurës penale, sepse nuk përmbajnë arsye mbi faktet vendimtare, se gjykata e shkallës së parë gjatë arsyetimit të aktgjykimit nuk i ka sqaruar në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i ka konsideruar të vërtetuara apo të pavërtetuara, e në veçanti dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin, ngase provat e administruara vetëm janë përshkruar, se është shkelur parimi i prezumimit të pafajësisë dhe parimi "In Dubio Pro Reo", sepse mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme interpreton në favor të akuzuarit, ndërsa në këtë rast nuk kemi vërejtur gjatë tërë këtij procesi të kanë vendosur në favor të tij, i dënuari nuk i ka pranuar asnjëherë veprat penale për të cilat ngarkohet, dhe se

në rastin konkret nuk ka pasur prova të mjaftueshme për shqiptimin e dënimit, por ka qenë dashur të lirohet nga akuza.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikoi shkresat e lëndës dhe analizoi pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit, konstatoi se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal, siç pretendohet në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit.

Siç u paraqiten edhe më lart, pretendimet mbrojtësit të të dënuarit janë të karakterit të përgjithshëm, pasi që i njëjti nuk theksuar se ku konkretisht qëndrojnë këto shkelje të pretenduara. Sidoqoftë, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se si aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë janë përpiluar në formën e parashikuar me ligj, pasi që përmbajnë të gjitha elementet që kërkohen sipas dispozitave përkatëse ligjore, si në pjesën e dispozitivit, ashtu edhe në pjesën e arsytimit. Dispozitivi i këtyre aktgjykimeve të kundërshtuara është i qartë, nuk është në kundërshtim me vetveten dhe është në harmoni me arsytimin.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë përshkruara në mënyrë të hollësishme veprat penale për të cilat është shpall fajtor i dënuari Q. M., së bashku me faktet dhe rrethanat e nevojshme që i përbëjnë figurat e veprave penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal, pasi që veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha elementet tipike të figurave të veprës penale “Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm”, nga neni 365, paragrafi 1 të KPRK-së dhe të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 374, paragrafi 1 të KPRK-së, për të cilat edhe është shpallur fajtor.

Nga kjo pjesë e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë së shkallës së parë rezulton se janë paraqitur këto elemente të figurës së veprës penale dhe atë: koha dhe vendi i kryerjes së veprave penale, ku rezulton se vepra penale ishte kryer me datën 24.07.2018, në bjeshkët e fshatit ..., komuna e Gj., tek vendi i quajtur “Livadhi i Babajve”, në atë mënyrë që ditën kritike, gjersa e dëmtuara N. L., së bashku me mbesën e saj L. M., ishin duke mbledhur boronica në bjeshkët e këtij fshati, për një moment e dëmtuara N., kishte dëgjuar një zë dhe atë “largohuni nga këtu he jau q... nanën”, i dënuari me të vërejtur se të njëjtat ishin duke mbledhur boronica, me një pushkë të gjatë (të cilin e kishte mbajtur pa leje) ka shtënë rreth dy herë përpjetë e më pas edhe dy shtëna tjera në drejtim të tyre, ashtu që me njëjërën nga të shtënat e qëllon të dëmtuarën N., dhe atë në pjesën e nënkukave, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupor dhe se me një veprim të tillë ka rrezikuar jetën e tyre, si dhe personave tjerë të gjetur në afërsi të vendit të ngjarjes, ndërsa menjëherë i dënuari ishte larguar nga vendi i ngjarjes në drejtim të panjohur. Në këtë mënyrë, rezulton se në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, tek pjesa e përshkrimit të veprimeve kryerëse janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme të gjitha rrethanat dhe faktet të cilat i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të figurës së veprave penale për të cilat është shpall fajtor i dënuari, ndërsa është e rëndësishme që të theksohet se të gjitha këto rrethana gjejnë mbështetje edhe në provat e administruara, kështu që në asnjë mënyrë nuk rezulton se kemi

kundërthënie në këtë drejtim, siç nuk bëhet fjalë për ndonjë shkelje tjetër ligjore, që do të mund të kishte ndikim në ligjshmërinë dhe drejtshmërinë e aktgjykimeve të kundërshtuara.

Përveç këtyre që u theksuan më lart, aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë arsye të mjaftueshme edhe sa i përket pikave tjera të rëndësishme, si dhe sa i përket rrethanave përkatëse lehtësuese dhe rënduese që janë marrë për bazë me rastin e matjes së dënimit, pasi që në këtë rast janë paraqitur, vlerësuar dhe arsyetuar të gjitha rrethanat relevante në këtë drejtim.

Të gjitha provat, duke përfshirë këtu edhe deklarimin e të dëmtuarës N.L., mbi bazën e të cilat është konstatuar fajësia e të dënuarit, rezulton se janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, të cilat më pastaj janë analizuar dhe vlerësuar, në mënyrën e parashikuar me ligj, ndërsa më pastaj, janë nxjerrë konkluzione të caktuara që i referohet si aspekteve faktike, ashtu edhe aspekteve juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe Gjykata Supreme e Kosovës.

Përndryshe, duhet theksuar se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë përmban pretendime të caktuara që ndërlidhen me gjendjen faktike, mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se konform nenit 432, paragrafi 2 të KPP-së, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike.

Në këtë mënyrë, nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar dhe pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.543/2024, më datë 12.09.2024

Bashkëpunëtore profesionale,  
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetar i kolegjit,  
Agim Maliqi